



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

M 358 post

Klos, më 24. 02.2024

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ Datë ___ / ___ / 2024

“NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 85, DATË 21.12.2022, PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR FILLIM PROCEDURASH ,PËR HEQJE DHE DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT KROM, NGA SHOQËRIA “Fabrika e Pasurimit të Kromit Bulqizë”.

Bazuar në “Ligjin 139/2015” për vetqeverisjen vendore, “Neni 54” shkonja “K”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014, “për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit, në zbatim të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, në Ligjin nr. 1034, datë 15.07.2010 “për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në VKM. 433, datë 08.06.2016, “për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike” në “VKM. Nr. 888, dt.27.12.2022, “Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe Nryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo Zgjerimi i tyre”, në VKM. Nr.1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor Publik”, Këshilli Bashkiak të

V E N D O S Ë:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes dhe dhënies në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor publik për “shfrytëzim të mineralit Krom, të sipërfaqes prej 0.9029 ha në N/ngastrën nr. 74a, në Ekonominë Pyjore Mali i Benjës-Cerujë. Zona Kadastrale Nr. 1137, Kodi Kadastral DI 3400 074a.

KRYETARI

Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE BUJQËSISË DHE PYJEVE
SEKTORI AMINISTRIMIT DHE MONITORIMIT TË PYJEVE DHE
KULLOTAVE

Klos, më . . .2024

RELACION SHPJEGUES

“NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 85, DATË 21.12.2022, PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR FILLIM PROCEDURASH , PËR HEQJE DHE DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT KROM, NGA SHOQËRIA “Fabrika e Pasurimit të Kromit Bulqizë” shpk.

Të nderuar Këshilltarë,

Ky relacion është hartuar duke u Bazuar në “Ligjin 139/2015” për vetqeverisjen vendore, “Neni 54” shkonja “K”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014, “për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit, në zbatim të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", në Ligjin nr. 1034, datë 15.07.2010 “për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në VKM. 433, datë 08.06.2016, “për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike” në “VKM. Nr. 888, dt.27.12.2022, “Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe Ndryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo Zgjerimi i tyre”, në VKM. Nr.1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor Publik”, urdhërin nr. 132, datë 30.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë. Ky ndryshim vendimi konsiston në saktësimin e N/ngastrës pyjore të kërkuar nga Ministria e Mjedisit, me shkresën nr. 43/1 prot, datë 19.01.2024.

Subjekti “Fabrika e Pasurimit të Kromit Bulqizë” shpk. ushtron aktivitetin minerar në vendin e quajtur Qaf-Lamë në malin e Allushit, N/ngastra nr. 74 a, Ekonomia Pyjore Mali i Benjës-Cerujë të ndodhur në territorin e bashkisë Klos. Grupi i punës i përbërë nga:

Ing. Nertil Bebja: Specialist i kadastrës pyjore, Petrit Cani: Specialist i mesëm pyjesh dhe Ing. Kapllan Allamani: Përgjegës i sektorit të pyjeve, me datë 30.09.2022 deri me datë 02.10.2022 studjoi kërkesën e subjektit “Fabrika e Pasurimit të Kromit Bulqizë” shpk, realizoi verifikimin në terren dhe regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore e kullosore me objekt: heqje nga fondi pyjor/kullosor dhe dhënie në përdorim për ”shfrytëzim të mineralit krom”.

Në bazë të raportit sipërfaqja prej 0.06 ha për sheshdepozitim dhe 1.7 km rrugë kalimi për shfrytëzimin e minerali të kromit, në zbatim të pikës 22, të urdhëzimit nr 1, datë 09.06.2016.

Në Ekonominë pyjore" Mali i Benjës-Cerujë".

Nëngastra 74a, vendi i quajtur Qaf-Lamë, në listën e inventarit rezulton pyll, me sipërfaqe 31.5 ha. Nga verifikimi në teren na rezulton pyll me pishë të zezë me drurë të rrallë.

Nëngastra nr. 76b, pyll, emërtimi popullor Qaf- Lamë, me sipërfaqe 16 ha.

Bazuar në: VKM. nr. 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre.

Hiqet nga fondi pyjor/kullosor 0.9029 ha, në Nëngastrën nr. 74a.

Kodi Kadastral DI 3400 074a,

Zona Kadastrale 1137.

Kufizimet: Veri: Nëngastrat 61b,c, Jug: Nëngastrat 76a,b, Lindje: Nëngastra nr.74b, Perëndim: Nëngastrat 67a, 68a.

Materiali drusorë i vlerësuar sipas të dhënave të terrenit për rrugë shërbimi me gjatësi 1.7 km, 0.06 ha sheshdepozitim dhe për heqjen nga fondi pyjor/kullosor që do të kryej subjekti “**Fabrika e Pasurimit të Kromit Bulqizë**” Sh.p.k. pas marrjes në përdorim të sipërfaqes me kontratë qeraje është 10 m³ lëndë punimi. Pasi gjatë aktit të verifikimit në terren që u krye nga grupi i punës u konstatua që sipërfaqja në fjalë është pyll pishë e zezë me drurë të rrallë.

Procedurat që ndiqen për dhënien me qera në fondin pyjor /kullosor publik janë mbështetur në VKM nr. 559, datë 29.07.2022,”Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

- Tarifa për përdorim rrugë shërbimi dhe sheshdepozitim të mineralit të kromit:

Tarifë në trungishte: 1.7 km. x 70000 = 119000 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë.
(shtojca nr. 1, pika 11.) për ndërtim/ përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë me rrjetin ekzistues.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe të akteve të tjera normative sa më sipër, shoqëria krye Sheshdepozitim $0.06 \times 120000 = 7200$ (shtatë mijë e dyqind) lekë (shtojca nr. 1 pika 9).

- Tarifa e materialit drusorë është : lëndë punimi e hollë $10 \text{ m}^3 \times 3000 = 30000$ (tridhjetë mijë) lekë. Tarifë që do paguhet vetëm vitin e parë.

Vlera e prodhimeve te dyta është 0 lek,

vlera e faunes eshte 0 lek.

Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime,zëvendësime,përmirësime) është 0 lek.

Vlera që do paguhet vitin e parë është 156200 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë. Tarifë vetëm për vitin e parë.

Vlera totale për cdo vit pasardhës është 126200 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind) lekë.

Për sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, VKM nr. 559, datë 29.07.2022, "Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". bazohen në afatet kohore sipas grafikut të punimeve të miratuara nga Institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

P/Sek të Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Kapllan Allamani

